

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E SHITES-SHTIMES
Nr. Prot. Br. Prot. 02/281
Nr. Fajvël/Br. strana 3
Data/Donal: 05.11.2024
SHTIMES-SHTIMES

Liaci
Giovanni
05.11.2024
12:43:15
GMT+01:00



05/11/2024
02/1156



KOMUNA SHITES



MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

NË MES TË

Komunës së Shtimes

DHE

Organizatës "Onlus protezione civile di Torchiarolo"

NË LIDHJE ME

Dhurimin e pajisjeve posturale

Ky Memorandum Bashkëpunimi (në vijim "Memorandumi") është hartuar dhe nënshkruar sot, më datë 05/11/2024, ndërmjet:

Komunës së Shtimes, me seli në adresën "Tahir Sinani", 72,000, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës së Shtimes, z. Qemajl Aliu (në vijim "Komuna"),

dhe

Organizatës "Onlus protezione civile di Torchiarolo", me seli në adresën në Itali përfaqësuar nga drejtori i Organizatës "Onlus protezione civile di Torchiarolo", z. Giovanni Liaci (në vijim "Organizata"),

Palët e përfshira në këtë Memorandum, Komuna e Shtimes dhe Organizatës "Onlus protezione civile di Torchiarolo", duke marrë parasysh rëndësinë e rritjes së mirëqenies sociale për qytetarët dhe nevojën për aspektin procedural të sigurimit të bartjes së pajisjeve bien dakord të bashkëpunojnë në këtë iniciativë. Kjo marrëveshje rregullon dhurimin e pajisjeve dhe procedurat përkatëse doganore.

Neni 1 Qëllimi i Memorandumit

Ky Memorandum ka për qëllim të formalizojë dhurimin e pajisjeve posturale Organizata "Onlus protezione civile di Torchiarolo për Komunën e Shtimes dhe të përcaktojë përgjegjësitë e palëve në lidhje me obligimet doganore dhe procedurat përkatëse.

Neni 2 Obligimet e palëve

1. Obligimet e Organizatës "Onlus protezione civile di Torchiarolo"
 - Organizata "Onlus protezione civile di Torchiarolo" dhuron pajisjet posturale për instucionet e shëndetësisë në Komunën e Shtimes që janë të listuara në Aneksin 1 të këtij Memorandumi.
 - Pajisjet e dhuruara do të jenë funksionale, të destinuara për përdorim në institucionet e shëndetësisë, sikurse QKMF, SHKSH, QPS.
2. Obligimet e Komunës së Shtimes
 - Komuna e Shtimes merr përsipër të gjitha obligimet doganore lidhur me zhdoganimin e pajisjeve mjekësore të dhuruara, duke përfshirë detyrimet që lidhen me procesin e zhdoganimit.
 - Komuna e Shtimes do të sigurojë që pajisjet të përdoren në mënyrë të përshtatshme dhe në përputhje me standardet dhe rregulloret përkatëse.

Neni 3 Pajisjet mjekësore të dhuruara

Pajisjet që do të dhurohen nga Organizata "Onlus protezione civile di Torchiarolo" për Komunën e Shtimes përfshijnë:

- N° 6 karrige posturale për fëmijë
- N° 7 mbajtëse dinamike për fëmijë
- N° 2 karrige me rrota për të rritur
- N° 3 kuti me aksesore posturale
- N° 36 palë këpucë të reja



Liçi
Giovanni
05.11.2024
12:43:15
GMT+01:00

Lista e detajuar e pajisjeve të dhuruara do të bashkëlidhet si Aneksi 1 i këtij Memorandumi.

Neni 4 Procedura e zhdoganimit

- Komuna e Shtimes do të marrë përsipër të gjitha procedurat për zhdoganimin e pajisjeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Komuna e Shtimes do të mbulojë të gjitha procedurat që lidhen me zhdoganimin, përfshirë taksat doganore, tatimet dhe çdo tarifë tjetër administrative.

Neni 5
Afati i zbatimit dhe ndryshimet eventuale

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi nga data e nënshkrimit dhe do të mbetet në fuqi deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të përcaktuara nga palët. Çdo ndryshim në këtë Memorandum mund të bëhet vetëm me marrëveshje të shkruar ndërmjet palëve.

Neni 6
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me zbatimin e këtij Memorandumi, palët do të përpiqen t'i zgjidhin ato përmes negociatave miqësore. Në rast të dështimit të negociatave, çështja do të zgjidhet në përputhje me ligjet në fuqi të juridiksionit përkatës.

Neni 7
Dispozita përfundimtare


Ky Memorandum është hartuar në dy (2) kopje, një për secilën palë, të cilat kanë të njëjtën fuqi ligjore.

Komuna e Shtimes


Dr. Qemal Aliu
Kryetar i Komunës së Shtimes



Onlus protezione civile
di Torchiarolo


Giovanni Liaci
Direttore di OIC-së
Liaci
Giovanni
05.11.2024
12:43:15
GMT+01:00

